



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimat / Dorezuar Primijseni/Profato Received/Delivery	07-06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SP/SHCK	4616/2023		1/6	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.665/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.665/2023 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_, Komuna e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit/ Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.665/2023 e datës 24.04.2023, e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_

II. Mbetet ne fuqi Vendimi Nr.prot:05/2023 i datës 13.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja, \_\_\_\_\_ cili sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 24.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3748/2023 të regjistruar me shenjen A.nr.665/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor me numër prot.05/2023 të datës 13.04.2023 lidhur me shqyrtimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes

faktike si dhe shkelje esenciale procedurale duke ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të legjislacionit për shërbimin civil, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative për arsye se e njëjta nuk është njoftuar me deklaratat e personave që janë marrë në pyetje nga Komisioni Hetimor, ashtu që procedura është dashur që të mbahet në mënyrë publike dhe me prezencën e përfaqësuesit nga Sindikata e Punëtorëve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 03.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses te Administrata Tatimore të Kosovës, ndërsa me datë 11.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me shenjen A.nr.665/2023 me numër të protokollit 3748/2023 të parashtruar nga ankuesja me datën 24.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor me numër prot.05/2023 e datës 13.04.2023; Vijueshmëria e hyrje daljeve për periudhën 01.02.2023 deri 28.02.2023; E-mail i dërguar nga S.M drejtuar K.D e datës 08.02.2023; E-mail i dërguar nga S.M drejtua Z.V e datës 27.02.2023; E-mail i dërguar nga Z.M drejtuar K.D e datës 15.02.2023; E-mail i dërguar nga Z.M drejtuar K.D e datës 21.02.2023; Pliko e bardh R 2892466; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.05.2023; Përgjigja në ankesë e datës 11.05.2023; Vendimi i Komisionit Disiplinor me numër prot.05/2023 i datës 13.04.2023; Procesverbal i seancës i datës 12.04.2023; Akt emërim me numër prot.02/931/11 i datës 29.02.2012; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës i datës 02.07.2012; Kërkesa e datës 17.03.2023; Raporti për rastin nr.03/23 i datës 17.03.2023; E-mail i dërguar nga A.S drejtuar N.G e datës 22.02.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar; Vendim i Komisionit Disiplinor me numër prot.02/2023 e datës 31.01.2023; Dokumentet për aplikimin e gjobës e datës 29.08.2014 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Formulari për vizitat tek tatimpaguesi i datës 06.10.2015(në gjuhën shqipe dhe serbe); Formulari për vizitat tek tatimpaguesi i datës 02.10.2015(në gjuhën shqipe dhe serbe); Vendimi lëshuar nga Zyra Noteriale me numër LRP.nr.7850/2020 i datës 17.09.2020 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Testament i datës 05.08.2019 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Deklaratë e trashëgimtares (në gjuhën shqipe dhe serbe); Vendim i përkohshëm i datës 25.10.2022 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Kopje e Gazetës prej 1-5 faqe; Diplomë me numër 3582 e datës 21.03.1989; Gjendje e llogarisë bankare e datës 30.11.2021; Lajm i gazetës i datës 21.04.2021 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Lajm i gazetës së datës 18.04.2021; Njoftim drejtuar H.M i datës 06.10.2015 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Raporti mbi sulmin fizik dhe kërcënimet i datës 25.10.2022 (në gjuhën shqipe dhe serbe); Kopje e letërnjoftimit për Z.M; E-mail i dërguar nga F.M drejtuar N.G e datës 02.03.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar I.S e datës 10.02.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga I.S drejtuar B.H e datës 10.02.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; Foto e bisedës ne viber e datës 10.02.2023; Shkresë drejtuar Misionit Eulex në Kosovë nga S.M; Deklaratë e N.R e datës 28.02.2023; Deklaratë e I.N e datës 28.02.2023; E-mail i dërguar nga N.G drejtuar S.M e datës 01.03.2023; Ftesë për intervistë e datës 01.03.2023; Deklaratë e S.M e datës 02.03.2023; E-mail i dërguar nga F.M drejtuar N.G e datës 03.03.2023; E-mail i dërguar nga S.M drejtuar N.G e datës 02.03.2023; E-mail i dërguar nga N.G drejtuar B.H e datës 06.03.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; Planoi ditor i datës 10.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; Plani ditor për datën 20.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; Plani ditor për datën 22.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; Plani ditor për datën 23.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e

datës 06.03.2023; Plani ditor për datën 24.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; Plani ditor për datën 27.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga N.H drejtuar A.S e datës 06.03.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 06.03.2023; E-mail i dërguar nga F.M drejtuar N.G e datës 07.03.2023; E-mail i dërguar nga N.R drejtuar B.H e datës 24.02.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G 27.02.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga T.M drejtuar N.G e datës 07.03.2023; Email i dërguar nga T.M drejtuar N.G e datës 07.03.2023; Email i dërguar nga N.G drejtuar T.M e datës 06.03.2023; Tabela e Vijueshmërisë për periudhën kohore 01.03.2023 deri 31.03.2023; Tabela e Vijueshmërisë për periudhën kohore 01.02.2023 deri 28.02.2023; Tabela e Vijueshmërisë për periudhën kohore 01.01.2023 deri 31.01.2023; E-mail i dërguar nga N.G drejtuar B.H e datës 13.03.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga N.G drejtuar A.S e datës 14.03.2023; E-mail i dërguar nga B.H drejtuar N.G e datës 13.03.2023; Formulari i vizitave i datës 14.12.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga F.M drejtuar N.G e datës 10.03.2023; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 25.01.2023; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë administrativ dhe profesional i datës 01.02.2023; Tabela e Raporteve për periudhën 01.01.2023 deri 02.03.2023; Pasqyra e tatimpaguesit A.A; Pasqyra e tatimpaguesit G.J.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses \_\_\_\_\_ është e pabazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht akt emërimit të ankueses i datës 29.02.2012 me nr.prot.02/931/11, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën e punës "Inspektor tatimor", ndërsa me datë 17.03.2023 Divizioni për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses ngase nga hartimi i raportit të datës 17.03.2023 me numër reference: rasti Nr.03/23 DSP është konstatuar fakti se ankuesja ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar e të datës 29.03.2023 e ka njoftuar ankuesen se ndaj të njëjtës është parashtruar kërkesë për iniciim të procedurës disiplinore, kurse nga procesverbali i datës 12.04.2023 konstatohet fakti se ankuesja ka marr pjesë në seancën disiplinore të ftuar nga Komisioni Disiplinor mbi bazën e të gjeturave të raportit 17.03.2023 të Divizioni për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa Komisioni Disiplinor përmes Vendimit me numër 05/2023 të datës 13.04.2023 i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5, 3.6, 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, lidhur me mungesat e paarsyeshme në punë për më shumë se pesë (5), dalje e pa arsyeshme apo largimi nga vendi i punës pa marr leje nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë gjatë orarit të punës, keqpërdorimi pasurisë apo asetëve shtetërore për qëllime personale apo përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar, kryerja e përsëritur e veprime që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi dhe shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar përmbajtjen e raportit për rastin me numër 03/2023 të datës 17.03.2023 të Divizioni për Standarde

Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës dhe listat e vijueshmërisë në punë nga Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore të ATK-së dhe ka gjetur se ankuesja me veprimet e saj e ka keqpërdorur orarin zyrtar të punës duke mos i arsyetuar mungesat në punë prej gjashtë (6) ditësh duke mos u regjistruar në sistemin e hyrjeve daljeve në datat: 03.02.2023; 07.02.2023; 08.02.2023; 10.02.2023; 13.02.2023; 14.02.2023, ndërsa ka bërë dalje pa paralajmëruar dhe njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë në datat: 16.02.2023; 22.02.2023; 23.02.2023; 23.02.2023 dhe 01.03.2023 dhe po ashtu, e njëjta nga shkresat e lëndës është konstatuar se përmes adresës elektronike zyrtare me datë 09.02.2023 ankuesja i dërgon e-mail Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës me përmbajtje (foto dhe shkrime për . . . . . ) i cili në vlerësimin e kolegëve të ankueses apo nëpunësve të tjerë civil paraqet figurë fyese dhe përgjegjës për masakra madje person i shpallur fajtor apo përgjegjës.

Kolegji i Këshillit, nga shkresat e administruara të lëndës e veçmas ato të ofruara nga pala ankuese përmes ankesës së parashtruar me datë 24.04.2023 nuk ka arritur të gjej asnjë provë relevante mbi bazën e së cilës ankuesja mund të arsyetoje pretendimet e saj ankimore, se e njëjta nuk ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës, madje në bazë të procesverbalit të datës 12.04.2023 konstatohet fakti se ankuesja e kishte ndjerë vetën përgjegjëse për gabimin e bërë me rastin e dërgimit të e-mailit me përmbajtje të padëshirueshme dhe jo zyrtar, sikurse nuk arrin ta dëshmojë me prova sikurse ajo pretendon se me datë 03.02.2023; 07.02.2023; 08.02.2023; 10.02.2023; 13.02.2023; 14.02.2023 ka qenë në punë porse kartela nuk i ka funksionuar, mirëpo edhe përkundër kësaj Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka identifikuar dhe konstatuar faktin se kartela e identifikimit në punë e ankueses ka qenë aktive dhe funksionale gjatë gjithë kohës, sikurse konstatohet edhe me faktin se e njëjta përgjatë datës 16.02.2023, 22.02.2023, 23.02.2023, 23.02.2023 dhe 01.03.2023 ishte lajmëruar në punë dhe kartela i kishte funksionuar porse e njëjta kishte dal pa paralajmërim nga vendi i punës pa pasur asnjë obligim zyrtar në teren dhe e njëjta nuk e kishte lajmëruar udhëheqësin e saj të drejtpërdrejtë.

Përveç shkeljeve disiplinore të përcaktuar si më lartë, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses Nenad Ristic me rastin e intervistimit nga Divizioni për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 28.02.2023 ndër të tjera kishte deklaruar se ankuesja refuzon pjesëmarrjen në takimet koordinuese të mëngjesit lidhur me shpërndarjen e detyrave dhe aktiviteteve ditore, refuzon të ngarkohet me detyra dhe përgjegjësi sikurse e njëjta nuk e mban të njoftuar dhe as nuk merr leje me rastin e daljes nga vendi i punës gjatë orarit zyrtar, madje udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë thekson faktin se gjatë periudhës së fundit dy mujore e njëjta nuk ka pranuar asnjë vizitë apo detyrë për kontrollë tereni dhe se të gjitha daljet e saj jashtë vendit të punës gjatë orarit të punës janë të pa arsyeshme. Po ashtu me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde, Kolegji i Këshillit ka marrë për bazë dhe Vendimin e datës 31.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore "ndalimi i 40% i pagës për periudhë gjashtë mujore" të shqiptuar ndaj ankueses Snezhana Miliq, masë e cila akoma është në fuqi dhe ndaj të cilës ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të cilën është nxjerr Vendim A.nr. 364/2023 i datës 03.04.2023 ku është vendosur që ankesa e ankueses të refuzohet, andaj në bazë të kësaj Kolegji i Këshillit konsideron se Vendimi i Komisionit Disiplinorë për Largim nga Shërbimi Civil është i arsyeshëm dhe i bazuar edhe në dispozitat ligjore të neni 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: "4. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj;

4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”, ku si rrjedhojë Komisioni Disiplinor ka marrë për bazë vazhdimësinë e veprimeve të ankueses dhe të njëjtës i ka shqiptuar një masë më të rëndë.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja me veprimet e përshkruara si më lartë ka bërë shkelje të obligimeve të parapara me nenin 25 paragrafi 1, nenin 26 paragrafi 1, nenin 27 paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe nenin 28 të Ligjit nr. 06/1 – 114 për Zyrtarët Publikë dhe shkelje të dispozitave të parapara me nenin 46 paragrafi 3.5; 3.6; 3.7; 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pasi ka munguar në punë pa arsye prej gjashtë (6) ditësh, po ashtu përgjatë gjashtë (6) ditëve tjera, kishte dal nga vendi i punës gjatë orarit zyrtar pa marr lejen e udhëheqësit të saj, përderisa e njëjta nuk ka qenë e ngarkuar me obligime apo kontrole inspektuese në teren për shkak të refuzimit të saj, dhe po ashtu për veprime të ngjashme për mosrespektimin e dispozitave të ligjit material dhe mos përmbushje të detyrave funksionale të punës ankuesja ka pasur të shqiptuar paraprakisht edhe një masë disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës, andaj mbi këtë bazë dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ankesa e ankueses dhe pretendimet e saja ankimore janë të pabazuara prandaj.

Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duke e mbajtur seancën e mbyllur dhe duke mos ftuar përfaqësues nga Sindikata e Punëtorëve si dhe e njëjta ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me rastin shqiptimit të masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” të datës 13.04.2023, ka analizuar dispozitat e nenit 12 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: “Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative” dhe lidhur me nenin 4 paragrafi 4 ku përcaktohet se: “4. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate” dhe ka ardhur në përfundimin se pretendimet e ankueses janë të pabazuara ngase edhe sipas rregullores së lartcekur përcaktohet qartë se seancat e komisionit disiplinor janë të mbyllura, kurse ankuesja mund të jetë e shoqëruar me përfaqësues të sindikatës nëse është anëtare e saj, mirëpo kjo mbetet në vlerësimin individual të ankueses pasi që Komisioni Disiplinor nuk obligohet sipas detyrës zyrtare që të ftojë ndonjë përfaqësues apo avokat për nëpunësin civil ndaj të cilit është hapur procedurë disiplinore.

Po ashtu, me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 si dhe nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: “1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil. 3.Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor, si nenit 8 paragrafi 1 dhe 3 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: “1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit 3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit”, si dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet ankimore të

ankueses janë të pabazuara, ngase masa e shqiptuar është disiplinore është në kompetencë të Komisionit Disiplinor dhe se të njëjtët kanë marrë parasysh se ankuesja ka pasur masë aktive për shkelje disiplinore, masë kjo ndaj së cilës ankuesja nuk ka reflektuar me evitim të sjelljeve apo respektimi të dispozitave të ligjit material dhe akteve të brendshme normative që ndërlidhen me përmbushjen e detyrave funksionale, sikurse ankuesja në mënyrë kumulative ka konsumuar elementet e përgjegjësive disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit nr. 06/1 – 114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe shqyrtimit provave të lëndës, si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa Vendimi Nr.05/2023 i datës 13.04.2023 i Komisionit Disiplinor është lënë në fuqi ngase është konstatuar se akti i kontestuar është nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material sikurse i përmban të gjitha elementet e përcaktuara të aktit administrativ siç parashihet me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj Vendimi Nr.05/2023 i datës 13.04.2023 i Komisioni Disiplinor mbetet në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicini i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.665/2023**

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetari i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së